

AKT THEMELIMI

PËR SHOQËRINË “GO Tomi’s Elektrik” SH.P.K.

F I E R

Në Fier sot me datën 04/06/2013, ne ortakët e shoqërise “GO Tomi’s Elektrik” sh.p.k.,

1. **TOMOR HAJDAR SHEHU**, datëlindja 29/03/1977, lindur në Kraps Fier dhe banues në Fier, lagje “Konferenca e Pezës”, mbajtës i letërnjoftimit ID numer 026107578, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i aftë për të kryer veprime juridike,
2. **KUJTIM TRIFON BUSHI**, datëlindja 05/08/1958, lindur në Çiflik Fier dhe banues në Fier, lagje “Konferenca e Pezës”, mbajtës i letërnjoftimit ID numer 027512736, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i aftë për të kryer veprime juridike,
3. **IOANNIS VASILEIOS SINOS**, datëlindja 11/03/1954, lindur në Athinë Greqi dhe banues në adresën: Amaliada Hlias Athina Greqi, mbajtës i letërnjoftimit numer AB 767708, me kombësi dhe shtetësi greke, i aftë për të kryer veprime juridike,

konform ligjit 9901 date 14-04-2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare”, hartojme kete akt themelimi:

“Me vullnetin tone te lire themelojme shoqerine me emertimin **“GO Tomi’s Elektrik” sh.p.k.** me seli ne Fier, lagje “Apollonia”, Pallati “Ardit 06”, pra shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortake TOMOR SHEHU, KUJTIM BUSHI dhe IOANNIS SINOS.

Themeluesat e kesaj shoqerie jemi ne ortakët TOMOR SHEHU, KUJTIM BUSHI dhe IOANNIS SINOS.

Selia dhe qendra e kesaj shoqerie eshte ne Fier, lagje “Apollonia”, Pallati “Ardit 06”.

Vula e shoqerise permban “GO Tomi’s Elektrik” sh.p.k. FIER-ALBANIA .--

Krijohet me mjetet financiare prone e ortakeve TOMOR SHEHU, KUJTIM BUSHI dhe IOANNIS SINOS, ne masen 100%, ne shumen prej 100 000 LEKE (NJEQINDMIJE) leke, te ndara ne 100 pjese me vlere nominale secila 1000 leke, ku secili prej ortakeve zoteron kete perqindje te kuotave te kapitalit:

- TOMOR SHEHU me 34% te kuotave te kapitalit te shoqerise,
- KUJTIM BUSHI me 33% te kuotave te kapitalit te shoqerise.
- IOANNIS SINOS, me 33% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kjo shoqeri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nenshtrohet legjislacionit perkates shqiptar.




Afati i veprimtarise se saj do te jete pesedhete vjet kohe. Ky afat mund te zgjatet dhe mund te shkurtohet ne rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe pasqyrohen ne statut.

Objekti i veprimtarise se shoqerise është:

- *Shitje dhe blerje materialesh elektrike, me shumicë dhe pakicë, import-eksport.*
- *Tregëtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport te materialeve elektro-shtëpiake, materiale elektrike dhe mekanike për linja prodhimi industrial.*
- *Projektim dhe zbatim të projekteve elektrike.*
- *Montime, shërbime dhe asistencë teknike për linja prodhimi industrial, ushqimore, etj.*

Organ vendimor ne shoqeri eshte Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve qe thirret ne seance te zakonshme te pakten nje here ne vit dhe drejtohet nga administratori i shoqerise. Asambleja merr vendime te zakonshme dhe te jashtzakonshme sipas dispozitave ligjore te percaktuara ne statut.

Shoqeria administrohet nga administratori i cili mund te jete nje nga ortakët, ose nje person tjeter. Kompetencat e administratorit percaktohen ne statut. Me themelimin e ketij akti, administrator i shoqerise caktohet z.TOMOR SHEHU.

Ne kete shoqeri mund te aderojne ortake te tjere te rinj ne kushtet qe do te percaktohen ne akt marreveshjen e bere ne rastin e pranimit te tyre.

Po ashtu ortaket kane te drejten te ndryshojne apo shtojne objektin e veprimtarise se shoqerise, sipas interesave te veta ekonomike dhe financiare.

Shoqeria ka te drejte te punesoje specialiste te fushes qe i perket objektit te veprimtarise si dhe punonjes te tjere me kontrate pune sipas percaktimeve ne Kodin e Punes dhe pergjithesisht me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Do te konsiderohen veprimtari te shoqerise vetem ato veprime juridiko-civile qe do te kryhen nga organet e saj konform disponimeve ne statutin dhe ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Si rregull veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, perjashtim nga ky rregull do te behet kur kerkon organi kompetent ligjor.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakut te vetem, administratorit dhe personave te tjere te punesuar ne shoqeri, ne rast se nuk zgjidhen me pajtim do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i ligjshem i kesaj shoqerie tregtare eshte ne favor te ortakeve te shoqerise ne masen: 34% per ortakun TOMOR SHEHU, 33% per ortakun KUJTIM BUSHI dhe 33% per ortakun IOANNIS SINOS.

Nderkohe ortaket mbartin mbi vete rrezikun e humbjes deri ne masen 100 perqind te kapitalit themeltar dhe atij rezerve, ne masen e perqindjes se kapitalit qe zotërojne.

Per detyrimet qe shoqeria mund t'ju kete personave te tjere juridike apo fizike pergjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.

Per funksionimin normal te shoqerise do te hartohet statuti i shoqerise ku do te parashikohen hollesite e mirefunksionimit dhe administrimit te saj.

Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

Kjo shoqeri mund te mbyll aktivitetin e vet ne rastet e parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe ne statutin e saj.

Shoqeria do te marre personalitet juridik me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar prane Qendres se Rregjistrimit te Bizneseve.

Nje kopje e aktit te themelimit se bashku me statutin e shoqerise, ruhen ne QKR."

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "GO Tomi's Elektrik" SH.P.K.

Tomor Shehu

Kujtim Bushi

Ioannis Karyne

Përkthyesi i gjuhës greke

Jorgo Harzi

